



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti, gjykatës raportues

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 23 mars 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër i Caktimit të Datës për Shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim

T'i njoftohet:

Mbrojtëses së Viktimave

Ani Pues

Mbrojtjes së të Akuzuarit

Julius von Bone

Zyrës Administrative

Fidelma Donlon

Ushtruesit të Detyrës së

Prokurorit të Specializuar

Aleks Uajting

Trupi Gjykses I (Trupi Gjykses) lëshon këtë urdhër të caktimit të datës për shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses nxori Aktgjykimin në çështjen aktuale.¹ Në Aktgjykim, Trupi Gjykses bëri të ditur se do të lëshonte më vonë Urdhrit për Zhdëmtim në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji).²

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

2. Trupi Gjykses vë në dukje nenet 22(3), (7) dhe (8), 43(2) dhe 44(6) të Ligjit dhe rregullave 159(2) dhe 164(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

III. ANALIZË

3. Trupi Gjykses kujton se, në përputhje me nenin 43(2) të Ligjit, aktgjykimi shpallet nga Trupi Gjykses publikisht.

4. Gjithashtu, Trupi Gjykses kujton se sipas rregullës 159(2) të Rregullores, vendimi i gjykimit, ose një përmbledhje e tij, shpallet publikisht në emër të popullit të

¹ KSC-BC-2020-05, F00494, Trupi Gjykses I, *Aktgjykim*, 16 dhjetor 2022, konfidencial. Versioni I redaktuar u dorëzua më 19 janar 2023, [F00494/RED](#), dhe versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023, [F00494/RED/COR](#).

² [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para 762, 831.

Kosovës, dhe në prani të të akuzuarit, përveçse kur rrethana të posaçme për ligjin mungesën e të akuzuarit.

5. Gjithashtu, Trupi Gjykes vë në dukje se, në pajtim me rregullën 164(2) të Rregullores, rregulla 159(2) e Rregullores zbatohet në mënyrë të ngjashme për vendimin e dënimit.

6. Meqenëse Urdhri për Zhdëmtim parashihet në nenin 44 të Ligjit, titulli i të cilit është "Dënimet", që shqiptohet përveç burgimit, Trupi Gjykes gjykon se dispozitat ligjore të përmendura më lart në Ligj dhe Rregullore zbatohen në mënyrë të ngjashme gjatë shqiptimit të Urdhrit për Zhdëmtim në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

7. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes ka vendosur, për arsye organizative dhe duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, se është e përshtatshme, në përputhje me rregullën 159(2) të Rregullores, që ta shqiptojë Urdhrin për Zhdëmtim në çështjen aktuale **të enjten, 6 prill 2023, në orën 12:00**, në seancë publike dhe në prani të z. Salih Mustafa.

IV. VENDIM

8. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses:
- a. **CAKTON** që Urdhri për Zhdëmtim në çështjen aktuale të shqiptohet **të enjten, 6 prill 2023, në orën 12:00**, në seancë publike; dhe
 - b. **URDHËRON** z. Salih Mustafa të jetë i pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit në selinë e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 23 mars 2023

Në Hagë, Holandë.